

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.H. nga fshati B., Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.21-5/2010 e dt.14.04.2010, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik me datë 25.02.2016, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Hava Krasniqi dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 10.03.2016, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

F. H., me nofkën M., i biri i A. dhe nënës Sh. , e vajzërisë H., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin B., KK P., ku edhe tani jeton, me nr. personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në autolarje, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, më parë i pa gjykuar, ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

I.Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit tëi sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në intervalin kohor prej 07.01.2010, rreth orës 19:00, deri me datën 08.01.2010, në ora 19:00, në fshatin B., në P., ka shkuar te shtëpia e fqinjëve të tije, të dëmtuarit I. H. dhe Y. H., ashtu që me përdorimin e forcës, me mjet të përshtatshëm të pa identifikuar ka thyr derën e lokalit-garazhit të të dëmtuarit I., ka depërtuar brenda dhe nga aty ka vjedhur vegla pune: dy hilla të dorës, dy shpuese-burmashina, një sharrë-cirkular, një ujëmatës-libelë, një fleksë, vegël pune për përpunimin e drurit-strugë, kurse të dëmtuarit I.H. duke i hequr pengesat ia ka marrë një derë alumini, të gjitha këto në vlerë rreth 1950€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle për këto vepra penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, PP.nr.21-5/2010 e dt.14.04.2010, kundër të akuzuarit F.H. nga fshati B., Komuna e P., për shkak veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë, dhe shqyrtimin gjyqësor, në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarve dhe të akuzuarit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprën penale për të cilat akuzohet.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetem pranë aktakuzës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi, se e ndjen veten të pa fajshëm duke shtuar se nuk është e vërtet se i kam kryer këto vepra penale, dhe kërkoj nga gjykata që ta shpall të pa fajshëm dhe ta liroj nga kjo aktakuzë.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët I. H., Y.H. si dhe janë lexuar: lista e provave materiale të datës 14.01.2010 si dhe fotodokumentacioni, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

I dëmtuari-dëshmitarit I.H. në shqyrtimin gjyqësor, veç tjerash ka deklaruar: Se ditën kritike kam vërejtur se depoja ka qenë e hapur dhe kanë munguar disa mjete të punës, të cilat mi ka sjellë vëllau nga Gjermania, e kamë ftuar policin kanë ardhë dhe më kanë pyetur se a dyshon në dikon?, ju kam thënë se jo, pas dy tri dite më kanë ftuar polica për ti identifikuar sendet të cilat edhe i kam marr afërsisht 80% të sendeve, dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike.

I dëmtuari-dëshmitarit Y. H., në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare veç tjerash ka deklaruar: Se nuk kam çka të them asgjë, sepse nuk e di se kush ka vjedhur vetëm kamë parë se mungon një derë, dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitarja A.H. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk dëshiron për tu deklaruar pas që ka dhënë deklaratë në prokurori, dhe të pandehurin e ka vëlla.

Nga lista e provave materiale të datës 14.01.2010, vërtetohet se në shupën që gjendet në oborrin e shtëpisë së familjes së të pandehurit janë gjetur sendet –mjetet e punës, të cilat janë identifikuar dhe janë kthyer të dëmtuarit.

Në fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, shihen sendet –mjetet e punës që janë fotografuar në oborrin e shtëpisë të pronarit A. H..

Nga administrimi i këtyre prova rezulton se nuk ka asnjë provë të vetme që vërtetojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale.

Gjykata ka marrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nëpar 1.3 të KPRK-së, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit, dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme, dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij, dhe bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar, në mungesë të provave tjera vendosi me aktgjykim lirues.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 dhe nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.106/2011 të dt. 21.01.2016

Sekretare juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.